



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 219/26 Dt. 14.05.2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të Rregullores (QRK) nr. 06/2023 për Kompensimin për Udhëtime Zyrtare dhe Shpenzime të Përfaqësimit, si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për lejimin e udhëtimit zyrtar

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, bazuar në ftesën e Shoqatës së Biznesmenëve dhe Miqësisë Turke-Kosovare (TUKIAD), për lejimin e udhëtimit zyrtar të Ajlin Shishko Hajdari, drejtoreshë e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për pjesëmarrje në Panairin Ndërkombëtar për Industrinë e Tekstilit, që mbahet në Porto të Portugalisë, nga data 19 maj 2026 deri me 22 maj 2026, kështu që, për këtë qëllim lejohen udhëtimi zyrtar, pagesa e mëditjeve, si dhe mbulimi i shpenzimeve të paparashikuara për të lartcekurën, konform akteve ligjore për udhëtimet zyrtare.
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në këtë vendim, do të sigurohet nga buxheti i Komunës—pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe i mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.
3. Obligohet Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Të lartcekurës,
 - Arkivës së Kryetarit.